

LIRIKA – Lasgush Poradeci

Themelues i poezisë moderne shqiptare:

- Ndjeshmëri e re = konceptimi i ri për poezinë, marrëdhënie dhe qëndrim i ri me poetikën
- Poezinë përpiqet ta largojë nga politika, ideologjitë, por e lartëson këtë art duke e sjellë si një **shfrim ndjenjash dhe emocione**
- Poezia dhe fjalët të kuruara
- Kërkim i thellë gjuhësor
- Mjete, teknika, figuracion të pashtershëm
- Lloje poetikash të reja, si p.sh. **trioleta** (përsëritja e një vargu), **soneti** (tingëllima)
- Përdorimi i simbolit
- Trajton tema të reja, por jo në mënyrat e vjetra
- **Dashuria si ndjenjë bipolare** (vjen me të kundërtat e saj: gëzim dhe dhimbje, liri dhe robëri)
- Karakteristikë është **lëvizja**, që vjen si proces
- Në këtë proces, si dukuri poetike, ai sjell përjetësinë, pafundësinë, pavdekësinë.
- **4 elemente**: toka, qielli, zjarri, uji (burimi i jetës)
- Poezi **kozmogonike** (e pafundme)
- Ka një **bosht filozofik**
- Dashuria nuk vjen si një ndjenjë e veçantë nga dhimbja e saj (bipolaritet)

Kuptimet për poezinë:

- Poezia shpreh shpirtin poetik
- Është e lirë nga propaganda
- Është emocion, jo ide
- I kushton rëndësi formës

Teknika:

- Dashuria s'vjen si ndjenjë, por si një fuqi themelore, e cila nxit, dikton lëvizjen/procesin
- E barazon, e lidh dashurinë me bukurinë (si Naimi)
- Poezia e dashurisë dhe në përgjithësi nis nga tradita, por nuk qëndron aty
- **Rimarrje**, p.sh. vashë, motër, shoqe etj.
- **Figuracioni popullor** për evidentimin e vajzës: me shikim të përmbysur, belëhollë, etj.

- Përherë i përulur dhe me adhurim për dashurinë: *përulur deri në dhé dhe ngritur deri në qiell*
- Ëndërrimi vjen si një karakter i paanshëm, i përsosur, i pafajshëm dhe këto tipare i jep dashurisë të projektuar, që në fëmijëri
- Pasioni vjen si kurorëzim i dashurisë, si zjarr e flakë (raporti intim me vajzën)
- Dashuria vjen si esencë e jetës dhe ekzistencës njerëzore
- Dashuri në distancë (kohë dhe vend)
- Vasha e papërcaktuar si portret
- Ia ngroh ndjenjën jo e dashura, por dashuria
- Duke qenë në distancë, shpesh vjen si mall, që kthehet në motiv
- Distanca sjell dhimbjen (forma vajtimtare)

Poezitë e liqenit

Liqeni:

- I shpirtëzuar, jo element gjeografik
- Shok e mik i përhershëm e intim
- Pasqyrë madhështie e përjetësisë
- Vendlindje dhe atdhe
- Lëvizja = dinamiika e shpirtit

Poezia filozofike

- Ballafaqimi poetik i jep sublimitet e përjetësi
- Një poezi filozofike ka një simbol: lundra, nositi, etj.
- Sjell bindjen se kërkuesi i përhershëm nuk është në tërheqje, por në sulm; nuk i shmanget vdekjes, po përball gjeratoren; njeriu s'e mposht vdekjen e vështirësitë duke ikur, por duke u përballur
- Pika heshtjeje, hapësira medituese, imgjinatë e fantazi
- Në raportin botë materiale-shpirtërore triumfon e dyta, që i jep pafundësi, përjetësi procesit (sipas poetit)
- **Motivi kryesor:** vetëfljimi (“Gjeniu i anijes”, “Lundra dhe flamuri”, “Vdekja e Nositit” dhe poezitë e liqenit)
- Paraqesin udhën e vështirë dhe të mundimshme të jetës, që kuptimin e merr tek ideali i lartë: përjetësia

Teknikat poetike:

- Larmi strofash
- Krijon marrëdhënie jap-marr si poezi e formës
- Gjuha burimore (fjali të përditshme)
- Neologjizma, p.sh. qielluar
- Lidhje fjalësh me kuptime të kundërta (oksimora), p.sh. dashuri për llaftari, vdekje me gaz
- Shmangie gjuhësore, p.sh. fjalët e përgjithshme shkruhen me shkronjë të madhe
- Shton tinguj në fjalë, p.sh. kufir
- Përdorim individual e autentik
- Fjalët me vijë në mes (funksion bashkues)
- Figura që formojnë imazh, figura tingëllore, që i japin ritëm dhe muzikalitet

Figurat e ndryshme:

- Vargu aleksandrian (6+çezurë+6, theksi bie te gjashta), ndonjëherë për shqiptarët është 14 rrokësh
- Asonanca (kur rimojnë vetëm zanoret)
- Aforizma (proverb, fjalë e urtë, konkluzion që vjen nga autori)
- Soneti (11 rrokësh, 4 strofa: 2 të parat me nga 4 vargje, 2 të fundit me nga 3 vargje)
- Figurat e përfytyrimit: shpirtëzimi, paralelizmi, hiperbola
- Figura të tingëllimit: onomatopeja, aliteracioni, asonanca, kosonanca
- Figura të sintaksës: përsëritja, epifora, anafora, epanalepsi, shkallëzimi, enumeracioni, inversioni, asindet, polisindet
- Apostrofi: drejtimi i dikujt a diçkaje sikur e kemi afër

Vdekja e Nositit

Me zjarr ju flas..., me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë-edhe t'j-a marr...

Un' ik liqerit zemërak
Fatlum dh' i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zogjtë-e mi,
Dh' u jap ushqim me dashuri-

Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! gjirin t'a godas...
Dh' e hap ah!-gjirin më një ças...,
Dh' i nginj ah! zogjtë-e vdes me gas!...

Ahere – helmohet e buçet
pas mallit t'im liqeri – i shkret,
e rrit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
ay e hap sa me të mund,
gjer mu në gjit, gjer mu në fund.

E shpirtin dyke m'a përcjellë,
më thotë-ah! Shif sesa 'sht i fellë
ky gjir' i em që të pat pjellë...

...Me zjarr ju flas, me zjarr.

Analiza metrike:

Poezia përmban 7 strofa dhe një varg të përsëritur në fund. Strofat janë tercina dhe brenda çdo strofe rima është AAA. Vargjet janë përgjithësisht 8 rrokësh.

Mjetet stilistikore:

Në gjirin tim kam hapur varr... (**metaforë**)

Që t'i jap shpresë-edhe t'ja mar... (**antitezë**)

liqeri zemërak (**epitet**)

i pastër si zëmbak (**krahasim**)

zemra ime kullon gjak (**metaforë**)

se vijnë urtuar zogjtë-e mi (**inversion**)

Me zjarr ju flas..., me zjarr (**anafora**)

Pa nis ah! gjirin ta godas.../ Dh'e hap ah!-gjirin më një ças.../ Dh'i nginj ah! zogjtë – e vdes me gas!... (**enumeracion, shkallëzim, anaforë, asindeta, metafora, inversioni**)

Ahere- helmohet e buçet (**shkallëzim**)

Pas mallit t'im liqeri-i shkret (**inversion, epitet**)

E rit tallazin posi det (**krahasim**)

zëmbak/gjak, dashuri/llaftari, zjarr/varr (**antiteza**)

Ay e tund, ay e shkund,/ Ay e hap sa me të mund,/ Gjer mun në gjit, gjer mun në fund. (**anafora, enumeracioni, shkallëzimi**)

është' i fellë (**epitet**)

Ky gjiri em që të pat pjellë... (**metaforë**)